



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	14.06.2018	Dep. DPK	Br. Prot. Prot. No. 03-03/1672/18
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1611/18	Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages 04	Data Datum Date 14.06.2018
PËR/ZA/TO:	z. Bekim DAKAJ Menaxher i zyrë së Prokurimit Akademia e Kosovës për Siguri Publike		
CC:	z. Ismail Dakaj Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike		
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Ndërtimi i Objektivit të shkollës në AKSP-ë” me nr. të prokurimit 214/18/3864/511, nr. të brendshëm 214/18/17/511.		

I nderuar z. Dakaj,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Ndërtimi i Objektivit të shkollës në AKSP-ë”** me nr. të prokurimit 214/18/3864/511, nr. të brendshëm 214/18/17/511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Ndërtimi i Objektivit të shkollës në AKSP-ë”** me nr. të prokurimit 214/18/3864/511, nr. të brendshëm 214/18/17/511, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 11 qershor 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-1611/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i Objektivit të shkollës në AKSP-ë**” me nr. të prokurimit 214/18/3864/511, nr. të brendshëm 214/18/17/511, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Akademia e Kosovës për Siguri Publike

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike, llojit punë, me vlerë të madhe të parashikuar 2,770,000.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, në kërkesën c. është kërkuar: “*Lista e projekteve të realizuara ne tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë*”, ndërsa tek dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: “*Së paku dy referenca të bashkangjitura me kontrata të përfunduara të ndërtimit të larë, minimum njëra referencë duhet të jetë në vlerë prej min 900,000.00euro apo procesverbali i pranimit të punëve nga kontraktuesi për tri vitet e fundit nga njoftimi për kontratë (e noterizuar)*”, kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Sipas Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 6.2. parashihet se Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë “Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; sa herë që është e mundur, Autoriteti Kontraktues mund të obligohet që të dakordohet me Autoritetin Publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse të i'a paraqes drejtpërdrejtë Autoritetit Kontraktues”.

Pra në këtë rast do duhej të kërkohej lista e kontratave bashkangjitur si dëshmi referencat mbi përfundimin e kontratave në vlerë totale të gjitha referencave të punëve të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë e jo si në rastin konkret ku është kufizuar numri i referencës në vlerën e caktuar.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë ekzekutimin e punimeve të ngjashme, andaj, autoriteti kontraktues duhet të këtë kujdes që të caktoj kërkesa minimale të kualifikimit.

Pas analizimit të njoftimit për kontratë. Agjencia ka vërejtur se autoriteti kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ndërsa si nën kriterë i ka caktuar: 1. Çmimi të cilit i ka caktuar koeficientin prej **0,70**, nën kriteri 2. Staf i profesional prej **0,20** dhe nën kriterin 3. Metodologjia **0,10**. Po ashtu, nën kriteri nr. 2. Staf i profesional 0,20, i specifikuar te kriteret e dhënies-tenderi ekonomikisht më i favorshëm, është kërkesë e cila njëkohësisht është kërkuara në nenin III.2.4. Kapacitetet teknike dhe profesionale në njoftimin për kontratë.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e caktimit të nën kriterit për dhënie të kontratës nr. 2 ku është caktuar *“Stafi profesional prej 0,20”* apo *“Menaxheri i projektit”*, nuk ka respektuar Legjislacionin në fuqi të Prokurimit Publik, për faktin se në nenin 28 paragrafi 3 Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimi Publik, specifikohen qartë cilat kriterë mund të caktohet te kriteri i dhënies Tenderi ekonomikisht ma i favorshëm.

Gjatë analizimit të dosjes së këtij tenderi dhe krahasimit me **njoftimin për kontratë** e cila është përgatitur nga ana e autoritetit kontraktues, Agjencia ka vërejtur se nënkriteret për dhënie të kontratës nuk janë identike njëra me tjetrën më saktësisht në lidhje me nën kriterin nr. 2 *“Stafi profesional prej 0,20”*, ku në njoftimin për kontratë është specifikuar, ndërsa në dosjen e tenderit saktësisht në Aneksin 6, te nën kriteri nr. 2, është specifikuar *“Menaxheri i projektit”*. Andaj, Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 27 paragrafi 4 të LPP-së, ku thuhet *“Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike”*.

Agjenci kundër Korrupsionit, rekomandon autoriteti kontraktues që në rast se specifikon në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriterin për dhënie të kontratës tenderin ekonomikisht më të favorshëm, duhet të këtë kujdes që të caktoj nën kriterë të qarta, precize dhe të cilat janë kriterë të matshme.

Agjenci kundër Korrupsionit, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit, 52 Njoftimi i kriterëve për dhënie të kontratës, si dhe nenin 69 Afërsitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !